

**DREJTORIA E ARSIMIT
DIREKCIJA OBRAZOVANJE
DEPARTMENT OF EDUCATION**Tel / Fax _____
Adresa _____
E- mail _____

	15. 06.2020
NR/BR.	365
PËR/ZA/TO	Publikim të konkursit për mësimdhënës në Gjimnazin “Dr. Shaban Hashani”
NGA/OD/FROM	Drejtori i Drejtorisë së Arsimit z. Afrim Llabjani
PËRMES/PREKO/RTHROUGH	Sektorit administrativ të Drejtorisë së Arsimit
LËNDA/PREDMET/SUBJEKT	Konkurs për mësimdhënës në Gjimnazin “Dr. Shaban Hashani” sipas Vendimit nr. 68/20 të Inspektoratit të Punës në Ferizaj

Mbështetur në nenin 8, të Ligjit të Punës, neni 35 paragrafi 1,4 dhe 5 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr. 04/L-032, neni 5 pika c, i Ligjit për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ të MASHT, i nr.10/2018. Normativi për Kuadrin e Arsimit të përgjithshëm dhe sipas **Vendimit nr. 68/20 të Inspektoratit të Punës në Ferizaj**, për shpalljen e konkursit publik për lëndën e Psikologjisë në Gjimnazin “Dr. Shaban Hashani” Drejtoria e Arsimit shpall:

K O N K U R S**Për mësimdhënës,**

Në shkollën e mesme Gjimnazi “Dr. Shaban Hashani” në Ferizaj:

-Një mësimdhënës për lëndën e psikologjisë.

Kushtet: Për vendet e punës për mësimdhënës kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimeve Administrativ të shënuara më lartë të MASHT- Normativi për kuadrin në arsimin e përgjithshëm.

Të drejtë aplikimi kanë kandidatët me përgatitje profesionale përkatëse.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën për shërbimin e qytetarëve, për Drejtorinë e Arsimit .

Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin në vijim:

-Diplomën e fakultetit, kopje e vërtetuar,

-Çertifikatën e lindjes,

-Letërnjoftimi kopje,

-Dëshminë se nuk është në procedurë hetimore ose nën hetim.

Kohëzgjatja: Kontrata e punës fillon nga data e fillimit të punës, deri më 31.08.2021. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni.

Dokumentet nuk kthehen.

Afati i konkursit është 15 ditë nga data e publikimit, në tabelën e shpalljeve, në web faqen e Komunitetit dhe në njërin nga mjetet e shkruara të informimit, duke filluar prej datës 15.06.2020, deri më 29.06.2020.